



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE
MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr.1083/1 prot.

Tiranë më 11.07.2023

Lënda: Mendim mbi projektligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

MINISTRISË SË DREJTËSISË

Tiranë

Në vijim të shkresës tuaj nr. 3879/1 datë 12.06.2023 me anë të të cilës është përcjellë për bashkërendim projektligji “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i konsoliduar me komentet e Komisionit Evropian, lutemi gjeni bashkëlidhur kësaj shkrese sugjerimet e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të cilat institucioni ynë në cilësinë e institucionit drejtpërdrejt përgjegjës për zbatimin e aktit ligjor në fjalë, i konsideron të domosdoshme për zbatimin me efektivitet të tij.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

- 1. Pas pikës 5, të nenit 33, të projektligjit,** Zyra e Komisionerit sugjeron lënien e pikës me përmbajtje si vijon:

“6. Nëpunësit për mbrojtjen e të dhënave mund të organizohen në kuadër të Dhomës Kombëtare të Nëpunësve për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Dhoma Kombëtare e Nëpunësve për Mbrojtjen e të Dhënave Personale krijohet dhe funksionon në formën e shoqatës, sipas parashikimeve të legjislacionit për organizatat jofitimprurëse. Projekt-Statuti miratohet paraprakisht nga Komisioneri.”

ose

“6. Nëpunësit për mbrojtjen e të dhënave mund të organizohen në shoqatë profesionale, sipas parashikimeve të legjislacionit për organizatat jofitimprurëse.

Sikurse është parashtruar edhe në komentet e përcjella më parë nga Zyra e Komisionerit, qëllimi i kësaj pikë është që të përcaktojë një rregullim dhe organizim profesional për Nëpunësit e Mbrojtjes së të Dhënave, sikurse ndodh me shumë profesione të tjera të lira ose jo. Ky propozim mbështetet dhe në raste konkrete në praktikën e vendit tonë, siç është rasti i Fondit Shqiptar të Zhvillimit apo rasti i Federatave Sportive. Roli i Zyrës së Komisionerit parashikohet të ketë qëllim tërësisht ndërgjegjësuese dhe këshillues lidhur me Dhomën, njëjtë si në rastet e përmendura më sipër për federatat sportive. Për më tepër kjo është edhe një detyrë e vendosur nga Kuvendi për Zyrën e Komisionerit edhe në *Rezolutën për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale*, të vitit 2021, pika 8 dhe 2022, pika 7 (<https://www.idp.al/rezolutat-e-kuvendit/>).

- 2. Lidhur me pikën 3, të nenit 74, të projektligjit,** i qëndrojmë propozimit tonë të mëparshëm me këtë përmbajtje: *“Komisioneri gëzon pagën dhe privilegjet e Kryetarit të Gjykatës së Lartë.”*

Në këtë propozim është marrë si referencë rasti i Autoritetit Italian për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (*Autorita Garante per la Protezione dei Dati Personali*), sugjeruar si model edhe nga ekspertët. Gjithashtu, në këtë sugjerim është marrë si rast edhe Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve si një institucion i pavarur, paga dhe privilegjet e të cilit barazohen me pozicionin e Kryetarit të Gjykatës së Lartë (*parashikuar në pikën 6, të nenit 13 të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar*).

Një parashikim i tillë mbështetet në parimin e indemnitetit, si një parim kyç në garantimin e disa prerogativave për titullarin e një institucioni, në funksion të mbarëvajtjes dhe drejtimit me efektivitet dhe integritet të institucionit nga ana e tij.

- 3. Pas pikës 3, të nenit 75, të projektligjit,** Zyra e Komisionerit sugjeron të shtohet pika 4, siç është propozuar më parë, me këtë përmbajtje: *“4. Komisioneri i nënshtrohet kontrollit financiar, për sa kohë kjo nuk ndikon tek pavarësia e tij”.*

Propozimi në versionin e paraqitur nga ana jonë është në përputhje me nenin 52 (6) të Rregullores së BE-së 2016/679 *“Për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave”* dhe preambulën 78 të

Direktivës 2016/680 të BE-së “Për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet kompetente me qëllim parandalimin, hetimin, zbulimin, ndjekjen e veprave penale ose ekzekutimin e dënimeve penale dhe për lëvizjen e lirë të të dhënave të tilla”. Dispozita synon të krijojë mekanizma që ruajnë pavarësinë e institucionit nga instrumente kontrolli, të cilët cenojnë pavarësinë. Shembull për këtë është rasti i detyrimit të përcaktuar nga Ministria e Financave për auditin e brendshëm me periodicitet 2 vjeçar. Kjo praktikë mund të cenojë pavarësinë e institucionit, sikurse rasti i kontraktimit të audituesve privatë, të cilët janë subjekt mbikëqyrje dhe monitorimi në cilësinë e kontrolluesve privatë nga ana e Zyrës së Komisionerit.

4. **Pas pikës 2, të nenit 76, të projektligjit**, Zyra e Komisionerit sugjeron të shtohet një pikë 3, siç është propozuar më parë, me këtë përmbajtje: *“Personeli i Zyrës së Komisionerit, për natyrë të veçantë pune përfiton një shtesë mbi pagën mujore sipas legjislacionit në fuqi.”* Një parashikim i tillë, përveçse është konstatuar edhe në iniciativa të tjera ligjore të sjella rishtazi pranë Zyrës së Komisionerit për mendim, si dhe është një praktikë e ndjekur edhe në autoritete homologe, është mëse i nevojshëm pasi puna pranë Zyrës së Komisionerit paraqet veçori sa i takon formimit dhe kualifikimeve profesionale të burimeve njerëzore. Sektori i mbrojtjes së të dhënave kërkon ekspertë të teknologjisë së informacionit dhe juristë të kualifikuar dhe të specializuar në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Duke qenë një fushë relativisht e re në vendin tonë, ka mungesë të ekspertëve të specializuar.

Konsideruar sa më sipër bashkë me faktin se puna në sektorin publik nuk paraqitet atraktive në aspektin financiar, e bën të vështirë identifikimin dhe rekrutimin e burimeve të përshtatshme në tregun e punës. Me zhvillimin e teknologjisë dhe rritjen e rëndësisë të mbrojtjes së privatësisë në sektorin privat, për shkak edhe të globalizimit të marrëdhënieve tregtare si dhe ndërveprimit me partnerë tregtarë në vende të BE-së, konstatohet një tendencë në rritje të ndjeshme e kërkesës për profesionistë me përvojë në këtë fushë, çfarë e bën të vështirë gjetjen dhe mbajtjen e nëpunësve të kualifikuar për një kohë të gjatë në detyrë.

Zyra e Komisionerit, si çdo autoritet homolog ka kompetenca mbikëqyrëse/monitoruese në nivel kombëtar me një shtrirje tërësore horizontale në të gjithë sektorin publik dhe në të gjithë sferat e veprimtarisë të çdo subjekti privat që nuk mund të konceptohet pa përpunim të të dhënave personale.

Tabloja e mësipërme bën që burime njerëzore të kualifikuara të Zyrës së Komisionerit të përthithen nga sektori privat, ose në rastin tjetër, ky sektor të përbëjë një barrierë për rekrutimin e burimeve të kualifikuara nga ana e këtij institucioni.

5. **Në pikën 5, të nenit 76, të projektligjit**, pas fjalisë së parë të shtohet një fjali me këtë përmbajtje: *“Nëpunësi civil më i lartë në stafin e Zyrës së Komisionerit është Sekretari i Përgjithshëm.”*

Për këtë fjali i jemi referuar modelit të Autoritetit Italian për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Dispozita ka të vetmin synim që të përcaktojë figurën/pozicionin që do të ushtrojë detyrat e Komisionerit në rast vakance të pozicionit të këtij të fundit për shkak të shkarkimit.

- 6. Në pikën 1, të nenin 81, të projektligjit** i qëndrojmë propozimit të mëparshëm mbi parashikimin e germës c) me këtë përmbajtje : “c) dhënien e mendimeve për projekt-aktet, ligjore dhe nënligjore, që kanë të bëjnë me të dhënat personale, si dhe projektet që kërkohen të zbatohen nga kontrolluesit vetëm apo në bashkëpunim me të tjerë;”

Kjo dispozitë bazohet në praktikën e krijuar dhe konsoliduar tashmë me ligjin aktual. Ajo garanton që projekt aktet e hartuara si dhe projektet e sektorit publik të cilat kanë të bëjnë me të dhëna personale, të kenë mendimin paraprak të Zyrës së Komisionerit, si institucioni kompetent i fushës, me qëllim garantimin e përputhshmërisë së tyre me këtë legjislacion.

Theksojmë se, nga ana e Zyrës së Komisionerit janë konstatuar raste projektesh të vëna në zbatim nga institucione qendrore, të cilat ushtrojnë edhe detyra me rëndësi thelbësore për shtetin (si menaxhimi buxhetor dhe menaxhimi i financave publike), të cilët rezultojnë në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Konstatime të tilla janë evidentuar gjatë hetimeve administrative të ndërmarra kryesisht nga ana e Zyrës së Komisionerit dhe janë reflektuar në aktet përkatëse “Raport i Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në kuadër të Rezolutës, datë 21.05.2020, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2019” apo rastet si ai i “Patronazhistit” ku një nga masat e garantimit të zbatueshmërisë dhe përputhshmërisë me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale është dhe dërgimi për mendim paraprak tek Zyra e Komisionerit të të gjitha projekt akteve.

Gjithashtu, parashikimi i kësaj pike është dhe një detyrim i lënë në Rezolutat e Kuvendit ndër vite në kuadër të vlerësimit të veprimtarisë së institucionit tonë.

- 7. Në nenin 83 të projektligjit**, nisur nga problematikat e ndeshura në praktikë në kuadër të ushtrimit të funksioneve ligjore, si dhe në përputhje me praktikën e ndjekura nga autoritete homologe (rasti i autoritetit italian), sugjerojmë të shtohet një fjali me këtë përmbajtje: “Në rast refuzimi për bashkëpunim nga ana e kontrolluesve publikë ose privatë, Komisioneri mund të kërkojë ndërhyrjen dhe mbështetjen e Policisë së Shtetit.”

- 8. Në pikën 1, të nenit 92 të projektligjit**, sugjerojmë që fjala “parandalues” të zëvendësohet me fjalën “dekurajues” .

Kjo për arsye se sanksionet administrative, në momentin e aplikimit të tyre, nuk mund të kenë më karakter parandalues.

- 9. Në nenin 96, të projektligjit**, sugjerojmë që të shtohet një fjali me këtë përmbajtje: “Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të aktit nënligjor në zbatim të paragrafit 3 të nenit 76.

- 10. Lidhur me nenin 99 të projektligjit**, sugjerojmë zëvendësimin e tij me atë të propozuar më parë, me këtë përmbajtje:

1. Ky ligj hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

2. Pika 3 e nenit 28, nenet 30, 31, 34, 35, pikat 2, 3 dhe 5 të nenit 66, nenet 64 dhe 67, hyjnë në fuqi dy vjet pas botimit të ligjit në Fletoren Zyrtare.

Duke pasur parasysh kohën që ligji mori për t'u hartuar dhe konsultuar, me grupet e interesit si dhe me shërbimet e Komisionit Evropian, gjykojmë që lënia e një periudhe 2-vjeçare do të cenonte interesat e kontrolluesve privatë (biznesit) të parashtruara.

Nevoja për miratimin sa më shpejt e ligjit të ri për mbrojtjen e të dhënave personale përafuar me GDPR-në është parashtruar si nevojë imediate nga ana e biznesit në forumet e organizuara nga Zyra e Komisionerit dhe jo vetëm, për shkak të marrëdhënieve që këto të fundit kanë me partnerët e huaj. Për këtë fakt Ministria e Drejtësisë ka dijeni të plotë.

Pikërisht për t'iu lënë kohë kontrolluese për t'u përshtatur me disa elemente novatorë të projektligjit është parashikuar që këto dispozita të hyjnë në fuqi për një periudhë 2-vjeçare. Ndërsa pjesa tjetër e ligjit e cila nuk paraqet ndonjë risi krahasimisht me legjislacionin ekzistues të mbrojtjes së të dhënave personale, të parashikohet hyrja në fuqi 3 ose 6 muaj pas botimit në fletoren zyrtare.

Gjithashtu në funksion të unifikimit të gjuhës, si dhe duke pasur parasysh faktin që vendi ynë nuk është vend anëtar i BE-së, sugjerojmë përdorimin në të gjithë tekstin e projektligjit të shprehjes “vend i huaj” në vend të shprehjes “vend i tretë”, të ndeshur në disa dispozita të ndryshuara nga ana e Ministrisë së Drejtësisë (*siç është për shembull, shkronja “g” e pikës 1, e nenit 34 të projektligjit*).

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi